**Shtojca 1**

**Formulari i kërkesës për leje mjedisore**

| | |
|---|---|
| Emri i kompanisë | **"TRIMI METAL" SH.P.K.** |
| Lloji i veprimtarisë | Depo për grumbullimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të mbeturinave: 13 01 01*, 13 02 04*, 13 02 05*, 13 02 06*, 13 02 07*, 13 02 08*, 13 05 02*, 15 01 04, 15 01 06, 16 01 03, 16 01 04*, 16 01 06, 16 01 07*, 16 01 13*, 16 01 19, 16 02 11*, 16 06 01*, 16 06 02*, 16 06 05, 16 06 06*, 16 08 01, 17 02 02, 17 02 03, 17 04 01, 17 04 02, 17 04 03, 17 04 04, 17 04 05, 17 04 06, 17 04 07, 19 10 01, 19 10 02, 20 01 01, 20 01 23*, 20 01 33*, 20 01 34, 20 01 35*, 20 01 36. |
| Vendi/lokacioni ku zhvillon veprimtarinë | Zona kadastrale Prizren<br>Rr. Jusuf Gërvalla pn.<br>Prizren |
| Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës si dhe vula e kompanisë | Pronar z. Leutrim Shaqiri<br>Menaxher z. Salih Gashi |
| Adresa | Rr. Besim Shala pn. Prizren |
| Telefoni, fax, e-mail | +383 44 919 104<br>+383 44 455 447 |
| Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis | Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati |
| Adresa | edonak88@gmail.com<br>+383 49 655 661<br>Lagja Prishtina e Re, Prishtinë |
| Përshkrimi i dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesës përfshirë numri e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit | **Nr. Biznesit: 811859539**<br>**Data e regjistrimit: 10.09.2021**<br>**Vendimi për pëlqim mjedisor**: 274-2/25<br>**Leje ndërtimore:** 04-351/02-67417<br>**Fletat poseduese**: 12225-479-06862<br>**Kopjet e planit**: 1825-481-09585<br>**Situacioni i terrenit** |
| Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë | Po |
| Fatura e pagesës së tarifës për leje mjedisore | Po |
| Aplikacioni origjinal i plotësuar për leje mjedisore në një (1) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD). | Po |

*Shtojca 2*
**Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore**

| | | |
|---|---|---|
| **APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE** | | |
| **1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME** | | |
| **1.1. Të dhënat për operatorin** | | |
| 1.1.1. | Emri i subjektit | **“TRIMI METAL” SH.P.K.** |
| | Vendi | Prizren, Republika e Kosovës |
| | Adresa | Rr. Besim Shala pn. Prizren |
| | Nr. i tel./fax | **Mobile:** +383 44 455 447 |
| | E-mail | trimi_metal@live.com |
| 1.1.2. | Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit | Nr. Biznesit: 811859539<br>Data e regjistrimit: 10.09.2021 |
| 1.1.3. | Personi përgjegjës i kompanisë | Pronar z. Leutrim Shaqiri<br>Menaxher z. Salih Gashi |
| | Nr. i tel./fax | +383 44 455 447<br>+383 44 919 104 |
| | E-mail | trimi_metal@live.com |
| 1.1.4. | Personi kontaktues përgjegjës për mjedis | **Dr. sc. Edona Kabashi-Kastrati** |
| | Nr. i tel./fax | +383 49 655 661 |
| | E-mail | edonak88@gmail.com |
| **1.2. Të dhënat për impiantin** | | |
| 1.2.1. | Emri i impiantit | **“TRIMI METAL” SH.P.K.**<br>Depo për grumbullimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të mbeturinave: 13 01 01*, 13 02 04*, 13 02 05*, 13 02 06*, 13 02 07*, 13 02 08*, 13 05 02*, 15 01 04, 15 01 06, 16 01 03, 16 01 04*, 16 01 06, 16 01 07*, 16 01 13*, 16 01 19, 16 02 11*, 16 06 01*, 16 06 02*, 16 06 05, 16 06 06*, 16 08 01, 17 02 02, 17 02 03, 17 04 01, 17 04 02, 17 04 03, 17 04 04, 17 04 05, 17 04 06, 17 04 07, 19 10 01, 19 10 02, 20 01 01, 20 01 23*, 20 01 33*, 20 01 34, 20 01 35*, 20 01 36. |
| 1.2.2. | Adresa e lokacionit të impiantit | Zona kadastrale Lubizhë, komuna e Prizrenit |

| 2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT | | |
|---|---|---|
| 2.1. | Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur | Lokacioni ku është ndërtuar dhe ka filluar veprimtarinë e saj kompania “TRIMI METAL” SHPK me aktivitet mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve: 13 01 01*, 13 02 04*, 13 02 05*, 13 02 06*, 13 02 07*, 13 02 08*, 13 05 02*, 15 01 04, 15 01 06, 16 01 03, 16 01 04*, 16 01 06, 16 01 07*, 16 01 13*, 16 01 19, 16 02 11*, 16 06 01*, 16 06 02*, 16 06 05, 16 06 06*, 16 08 01, 17 02 02, 17 02 03, 17 04 01, 17 04 02, 17 04 03, 17 04 04, 17 04 05, 17 04 06, 17 04 07, 19 10 01, 19 10 02, 20 01 01, 20 01 23*, 20 01 33*, 20 01 34, 20 01 35*, 20 01 36, gjendet në njësitë kadastrale P-71813046-00515-0 dhe P-71813046-00528-0 me sipërfaqe S = 8816 m2 dhe 4222 $m^2$, në vendin e quajtur Belo Drov-Ispod Puta, zona kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit. Ky projekt ka si aktivitet grumbullimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave metalike. Ngastrat janë me sipërfaqe prej S = 8816 $m^2$ dhe 4222 $m^2$ me formë jo të rregullt gjeometrike, ku dhe mund të verifikohet në bazë të fletave poseduese dhe kopjëve të planit të lëshuar nga zyra e kadastrit, poashtu me anë të këtyre dokomenteve është dëshmuar e drejta pronësore – juridike e cila është në emër të parashtruesit të kërkesës të “TRIMI METAL” SHPK.<br>Lokacioni ku është vendosur kompania TRIMI METAL shpk gjendet në anen e majtë të rrugës magjistrale Prizren - Suharekë, përkatësisht në zonën kadastrale Lubizhdë, në kilometrin e dytë të kësaj rruge. Pozita e aktivitetit të lartëcekur është mjaft e volitshme, me një infrastrukturë të pajisur teknike ka një mundësi mjaft të mirë, objektet kenë pamjen Jug – Përendim dhe shërbej për nevojat e deponis së mbeturinave metalike. |




*Fig. 1. Pamja satelitore dhe harta topografike e lokacionit*

Zona ku është duke u zhvilluar aktiviteti për grumbullimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave, shtrihet në pjesën veri - lindore nga qendra e Qytetit i Prizrenit gjegjësisht në kilometrin e 2-dytë përgjatë rrugës tranzite e cila lidhë verin e Prizrenint me magjistralen Prizren - Suharekën, ndërsa ngastrat kanë qasje në anën lindore të kësaj magjistrale.

Rrugët me të cilat kufizohet lokacioni i deponisë nuk janë të asfaltuara, por i plotësojnë në tërësi kriteret për funksionim normal.

Më poshtë janë të bashkangjitura situacioni i terenit dhe ngastrat se ku është duke u bërë realizimi të këtij aktiviteti.




| Koordinatat e parcelave | | |
|---|---|---|
| Nr. | Y[m] | X[m] |
| 1 | 7479646.526 | 4679653.740 |
| 2 | 7479635.117 | 4679632.450 |
| 3 | 7479620.147 | 4679604.381 |
| 4 | 7479608.817 | 4679582.992 |
| 5 | 7479567.576 | 4679611.694 |
| 6 | 7479554.876 | 4679618.415 |
| 7 | 7479511.485 | 4679645.317 |
| 8 | 7479541.315 | 4679685.765 |
| 9 | 7479564.235 | 4679711.094 |
| 10 | 7479605.366 | 4679682.332 |
| 11 | 7479631.716 | 4679663.910 |
| 12 | 7479796.280 | 4679488.863 |
| 13 | 7479787.820 | 4679470.343 |
| 14 | 7479773.590 | 4679480.524 |
| 15 | 7479746.200 | 4679499.625 |
| 16 | 7479724.799 | 4679515.866 |
| 17 | 7479686.278 | 4679541.648 |
| 18 | 7479673.258 | 4679547.129 |
| 19 | 7479651.948 | 4679557.440 |
| 20 | 7479619.507 | 4679576.402 |
| 21 | 7479616.377 | 4679577.642 |
| 22 | 7479640.647 | 4679581.530 |
| 23 | 7479682.708 | 4679564.608 |
| 24 | 7479725.009 | 4679536.586 |
| 25 | 7479767.530 | 4679509.204 |

| | | |
|---|---|---|
| 2.2. | Numri kadastral i parcelës | Lokacioni i kompanisë “TRIMI METAL” shpk ndodhet në njësitë kadastrale P-71813046-00515-0 dhe P-71813046-00528-0 me sipërfaqe S = 8816 m$^2$ dhe 4222 m$^2$, në vendin e quajtur Belo Drov-Ispod Puta, zona kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit. Gjithënjë sipas Certifikatave të pronësis me nr. të lëndës 12225-479-06862; 12225-479-06851 dhe kopjet e planit nr. 1825-481-09585, lëshur me datë 01.08.2025, zyra kadastrale Prizren. |
| 2.3. | Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë | Në këtë lokacion nuk ka shtëpi banimi apo objekte afariste me veprimtari të ngjashme ose të ndryshme. Toka e lokalitetit klasifikohet si tokë bujqësore, me shfrytëzim aktual si arë, dhe është e klasës së pestë për nga cilësia.<br>Depoja për grumbullimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave, sipas kodeve të përmendura më herët, ka një pozitë të favorshme për realizimin e |

| | | |
|---|---|---|
| | | aktivitetit përkatës. Mungesa e shtëpive të banimit dhe objekteve afariste në afërsi bën që ky aktivitet të mos paraqesë shqetësim për banorët lokalë apo për komunën e Prizrenit.<br>Sa i përket infrastrukturës rrugore, lokacioni ka qasje të mirë përmes rrugës magjistrale dhe tranzitit të ri që lidhet me magjistralen Prizren–Suharekë. Në anën perëndimore, tranziti i ri ka dalje në magjistralen Prizren–Gjakovë dhe ndodhet shumë afër kyçjes në autostradën "Ibrahim Rugova". Kjo pozitë e favorshme lejon lidhje të lehtë përmes disa rrugëve dytësore me rrugët kryesore, pa krijuar pengesa për pjesëmarrësit tjerë në trafik.<br>Në një distancë mbi 1 km ndodhen disa objekte me veprimtari të ndryshme tregtare dhe prodhuese. |
| 2.4. | Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion | Ajo që dallon florën dhe faunën e këtij regjioni më të gjerë janë ndryshimet intensive që kanë filluar si pasojë veprimtarisë së njeriut, kryesisht për zhvillim industrial të kësaj ane. Në rrethin të ngushtë të lokacionit flora dhe fauna janë shumë të zhvilluara. Në sipërfaqet në regjionin më të gjërë posaçërisht në ato që ekzistojnë në ultësinë ekzistojnë sipërfaqet e tokave livadhor, andaj edhe karakteristike janë llojet bimorë të përshtatshme për livadhe, kryesisht kultura te ndryshme bujqesore te kultivuara nga ana e bujqëve të rrethnës. Mirëpo në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethin të zonës ku do të realizohet aktiviteti nuk kemi hasur në bimësi që karakterizohen me vlera reprezentative kryesisht nga bimët e ulta barishtore. Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mund të rrezikohen me funksionimin e depos për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave me kodet e lartëcekura, në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit. Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve shtazore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore në këtë domen. Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit më të gjerë, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në zonën më të largët nga lokacioni jetojnë gjitarët, insektet e ndryshme, lepuri i egër, |

| | | |
|---|---|---|
| | | dhelpra, ujku, iriqi etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, thëllëza e fushës, sorra etj. |
| 2.5. | Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes | Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokalitet, kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi. |

| **3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË** | | |
|---|---|---|
| **3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet leja mjedisore** | | |
| 3.1.1. | Skema e procesit teknologjik |   |
| 3.1.2. | Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik | Në kompleksin e kompanisë “Trimi Metal” shpk e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve: 13 01 01*, 13 02 04*, 13 02 05*, 13 02 06*, 13 02 07*, 13 02 08*, 13 05 02*, 15 01 04, 15 01 06, 16 01 03, 16 01 04*, 16 01 06, 16 01 07*, 16 01 13*, 16 01 19, 16 02 11*, 16 06 01*, 16 06 02*, 16 06 05, 16 06 06*, 16 08 01, 17 02 02, 17 02 03, 17 04 01, 17 04 02, 17 04 03, 17 04 04, 17 04 05, 17 04 06, 17 04 07, 19 10 01, 19 10 02, 20 01 01, 20 01 23*, 20 01 33*, 20 01 34, 20 01 35*, 20 01 36, kompania në fjalë posedon hapësirat si në vijim:<br>- Hapësirën për zyrën për personelin dhe për punëtorët ndihmës, |

- Hapësirën për ushqim dhe nyjet sanitare,
- Hapësirat për pranimin, peshimin dhe shkarkimin e mbeturinave dhe automjeteve mbeturinë nga kamionët,
- Hapësirën dhe autoservisin për çmontimin dhe deponimin e mbeturinave,
- Hapësirën për imtësimin dhe presimin e mbeturinave metalike,
- Hapësirat për vendosjen e pjesëve të mbeturinave metalike të klasifikuara dhe ambalazhuara,
- Objektin për vendosjen e pjesëve të çmontuara të automjeteve mbeturinë, siç janë, mbeturinat metalike, akumulatorëve mbeturinë, hekur, çelik, alumin, inoks, bakër, plastikë, qelq, elektrombeturina si dhe vaj motorik mbeturinë e fluide tjera mbeturinë, etj,
- Platon (hapësirat) për vendosjen e automjeteve (shtëpizave të automjeteve).
- Hapësirat për klasifikimin dhe ambalazhimin e pjesëve të elektrombeturinave.
- Rezervar/bure, 1 copë me kapacitet prej 10.000 litra per deponin e naftës dhe 3 copë me kapacitet prej 1000 litra për vendosjen e vajit motorik të vjetër (të përdorur), vajin e ndërrusit të shpejtësive, për vajin e frenave, etj.
- Vaskën për kontrollin dhe derdhjen e vajërave eventualisht të mbetur.

**Përshkrimi i llojit të mbeturinave sipas grupeve të kodeve dhe procesi teknologjik që kryhet me ato mbeturina.**

**KODET me nr.13;** *130101*, 130204*, 130205*, 130206*, 130207*, 130208*, 130502**

Kompania “Trimi Metal” shpk nuk bënë mbledhjen e vajrave nga kompanit tjera, por vajrat të cilat vijnë në deponi me automjetet mbeturinë si; motor, kutin e ndërrusit të shpejtësive, vajrat

| | | |
|---|---|---|
| | | hidaulike dhe të frenave, largon me kujdes vendosen në enë të posaçme dhe sipas llojit vëndosen në fuqit apo rezervarët për deponimin dhe ruajtjen e tyre.<br>Kompania sipas projektit kryesor ka bërë betonimin e gjithë sipërfaqës operacionale dhe ndërtimin e një kanali drenazhues perimetrik përreth gjithë sipërfaqës operacionale, me qëllim grumbullimin e ujërave atmosferike dhe ujërave që krijohen nga pastrimi i sipërfaqeve operacionale. Këto ujëra grumbullohen në seperatorin për ndarjen e vajërave dhe mbeturinave të ngurta nga uji dhe në mënyrë periodike bëhet seperimi/largimi i vajit nga uji dhe pastrimi i llumrave që mbesin në seperator.<br>**KODET me nr. 15.** *15 01 04, 15 01 06;* ambalazhet metalike dhe ato të përzira që vijë kryesisht nga pijet, ushqimi dhe mbeturinat të ngjashme kompania i grumbullon në deponi i pastron i klasifikon sipas përbërjes dhe të njëjtat presohen në formën e ballave, palohen në paleta, paketohen dhe magazinohen si të gatëshmë për shitje.<br>**KODET me nr. 16.** *16 01 03, 16 01 04*, 16 01 06, 16 01 07*, 16 01 13*, 16 01 19, 16 02 11*, 16 06 01*, 16 06 02*, 16 06 05, 16 06 06*, 16 08 01;* në kuadër të këtyre kodeve futen mbeturinat me llojin dhe masën më të madhe të mbeturinave që do të përdoren në procesin teknologjik. Duke e ditur se nga masa e përgjithshme e automjeteve 80 % e saj mund të përdoret si mbeturin metalike. Procesi i çmontimit të automjeteve kryhet për shkak se automjetet janë të përbëra prej numrit të madh të materialeve të ndryshme që hynë në përbërjen e automjeteve, ato pjesë çmontohen, selektohen, magazinohen dhe shiten si të tilla.<br>Automjetet në përgjithësi përbëhen nga metalet që bëjnë pjesë mbi 76% të përbërjes së automjeteve siq janë Fe, Al, Cu, çeliku e metalet tjera konsiderohen me vlerë të veçantë dhe bëjnë pjesë në resurse natyrore të paripërtritshme. |

| | | |
|---|---|---|
| | | ***Qelqi*** - i cili përmban 3% nga masa e automjetit nuk shfrytëzohet/riciklohet (i njëjti klasifikohet në repartet për grumbullimin e qelqit të automjeteve, dhe shitet si i tillë).<br>***Lëngjet në automjete* -** (derivatet e naftës, llojet e ndryshme të vajrave dhe lëngjet për ftohje, etj) përbëjnë 6% të masës së automjetit. Lëngjet e automjeteve në procesin e demontimit të automjeteve paraqesin një problem kompleks për shkak të përbërjes kimike dhe toksike kur dihet se një pike vaji i përdorur i automjeteve ndotë 1$m^3$ ujë, për çka duhet patur kujdes në deponimin e tyre ashtu që të mos derdhen në tokë por të deponohen në rezervuarë të caktuar të cilet pastaj duhet shitur/larguar aty me kujdes dhe sipas standardeve, rezervuaret nuk janë vendosur drejteperdrejt në tokë por në vaska metalike që janë ndërtuar posaçerisht për to, rezervarët janë me vëllime të vogëla vendosën në vaska metalike. Vaska janë me dimensionet e tilla që të kenë kapacitet të barabart me kapacitetin e rezervuarave që janë të vëndosur në vaska, poashtu vaskat kenë edhe kanalin e drenazhimit të ujërave atmosferike dhe lidhjen e tij me gropat sedimentuese. Vaskat metalike janë vëndosur në hapësirat të mbuluara dhe në vende të sigurta.<br>***Gomat* –** janë një komponet tjetër e cila haset poashtu në makinat dhe e cila përmban 4% të masës së automjetit, të njëjtat largohen nga makina në autoservis pastaj deponohen në depo deri sa të shiten. Në asnjë mënyrë gomat dhe pjesët tjera të makinës nga goma nuk përfundojë në deponit e egra, sepse konsiderohet si ndotje e rëndë për mjedisin, por goma shitet në kompanit ose fabrikat që merren me përpunimin e tyre. Pjesët e automjeteve që paraqesin rrezik të madh për mjedisin jetësor janë akumulatorët dhe filtrat e vajrave.<br>***Akumulatorët*** - Bateritë paraqesin burime kimike të rrymës njëkahore elektrike dhe përdorën për ngasje (startim) të |

| | | |
|---|---|---|
| | | automjeteve të ndryshme, si dhe në industri për qëllime të ndryshme. Akumulatorët nuk paraqesin vetëm interes ekonomik por janë me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e mjedisit kur kemi parasysh përbërjen e tyre. Akumulatorët kryesisht janë “akumulatorë plumbi” që bëjnë pjesë në grupin e baterive sekondare (rimbushëse). Përbërja e bazë e akumulatorit është kjo:<br>1. Pjesët metalike me përbëje të ndryshme të Sb.<br>2. Masa aktive për mbushjen e pllakave (që përbëhet nga PbSO4 dhe PbO2 në raport 1:1)<br>3. Pllakat izoluese dhe shtëpiza nga plastika 4. $H_2SO_4$ me conc. të caktuar.<br>Kjo përbërje e akumulatorit mund të jetë: a) masa aktive 38 % b) metal 35 % c) acid sulfurik 22 % d) plastika 5 %. Nga kjo paraqitje vërehet se akumulatori përmban pjesë toksike për mjedisin, prandaj gjatë deponimit në depo tregohet kujdes në manipulimin me akumulatorë dhe vendosen në pjesën e mbuluar të platosë me bazë betoni e cila është e izoluar. Akumulatorët qëndrojnë në depo deri atëherë kur mirën nga kompanitë e licencuara, pra kompania “Trimi Metal” shpk, nuk do të bëjë riciklimin e akumulatoret, por të njëjtit shiten ashtu siç janë.<br>***Filtrat e vajrave*** - konsiderohen si material i rrezikshëm për mjedisin, vendosen në kontinjer/vaska të caktuara nga pastaj ruhen në vendet e mbuluara dhe të shtruara me beton izolues, deri në momentin e tregëtimit/shitjës së tyre.<br>***Elektrolitet nga baterit dhe akumulatorët*** – nese kemi ndonjë bateri e cila ka ndonjë dëmtim fizik apo që ka rrjedhje ajo vëndoset në vasken e veqant për largimin e atij elektroliti (acidi të fortë). Pastaj elektroliti neutralizohet me NaOH ose KOH dhe ujë te thjeshtë deri në pH neutrale (pH rreth 7) që nuk paraqet rrezik për mjedisn dhe si i tille mund te shkarkohet. |

| | | |
|---|---|---|
| | | ***Karalizatorët e harxhuar të makinave*** – këto paisje në makina përdoren për pastrimin e gazërave dhe largimin e gazit karbonik $CO_2$. Katalizatorët largohën nga makina klasifikohen, magazinohen në depo deri në momentin e shitjes tek kompanitë.<br>***Paisjet për hudhje që përmbajnë kloroflorokarbone*** – janë kryesisht paisjet elektrike që ndodhen në makina. Duke e ditur që viteve të fundit makinat në masë të madhe kanë avnacuar në drejtim të atyre elektrike dhe me shumë pjesë elektrike të instaluara, edhe nevoja për trajtimin e këtyre mbeturinave është rritur. Këto lloje të mbetruinave sikurse edhe pjese tjera në makinave nuk do të kenë ndonjë proces teknologjik të veqant në kompanin “Trimi Metal” shpk në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit. Paisjet elektrike largohen nga makinat, klasifikohen dhe magazinohen deri në shitje.<br>Me këto pjesë të automjeteve të lartëcekura tregohet kujdes dhe kanë një tretman të veçantë, pra këto komponente nuk çmontohen ose përpunohen, por vetëm grumbullohen, magazinohen, paketohen dhe shiten si të tilla.<br>**KODET me nr. 17.** *17 02 02, 17 02 03, 17 04 01, 17 04 02, 17 04 03, 17 04 04, 17 04 05, 17 04 06, 17 04 07;* në kuadër të këtyre kodeve kryesisht bëjnë pjesë mbeturinat nga një llojë material psh. qelqi, plastika, metalet si bakër, bronz, tunxh, alumin, plumb, zink, hekur, çelik, kallaj dhe metalet e përzira (aliazhet), këto lloje të mbeturinave i grumbullon kompania “Trimi Metal” shpk dhe të njëjtat klasifikohen, disa prej tyre presohen disa imtësohen magazinohen dhe shiten/tregëtohen.<br>**KODET me nr. 19.** *19 10 01 dhe 19 10 02;* këto mbeturina kryesisht krijohen nga procesi i bluarjës, imtësimit dhe presimit të mbeturinave metalike si psh. automjetet mbeturinë apo edhe metalet mbeturinë tjera të ngjyrosura. Mbetjet nga ky proces teknologjik mbledhen, vendosen në thasë të veqantë për ruajtjen |

| | | |
|---|---|---|
| | | dhe magazinimin e këtij materiali dhe i njëjti shitet, pra nuk bëhet asnjë trajtimi i caktuar kimik apo termik kësaj mbeturine.<br>**KODET me nr. 20.** *20 01 01, 20 01 23*, 20 01 33*, 20 01 34, 20 01 35*, 20 01 36;* të gjitha këto lloje të mbeturinave përveç letëres dhe kartonit janë përmendur më lartë, ndërsa sa i përket mbeturinave nga letra dhe kartoni të cilat vijnë në deponin e kompanisë “Trimi Metal” shpk, janë kryesisht material ambalazhuese të cilat kompania i grumbullon, klasifikon, preson në formen e ballave i magazinon dhe i shet si të tilla.<br><br>***Fazat e procesit teknologjik*** – mbledhja dhe grumbullimi bëhet duke i transportuar të gjitha llojet e mbeturinave me kodet e lartëcekura gjerë të platoja për peshimin, pastaj sipas llojit të mbeturinave dërgohen në repartet e dedikuara për trajtimin e atyre mbeturinave. Në rastet kur mbeturina është automjet dërgohet në vendin/servisin ku kryhet largimi nga automjeti i derivateve, gomave, akumulatorëve dhe pjesëve tjera përbërëse. Derivatet deponohen në rezervarët e posaçëm, akumulatorët dhe gomat magazinohen në hapësirat e përshtatshme në depo gjerë në paketim dhe shitjen e tyre. Pastaj automjeti dërgohet në hapësirën për largimin e motorit, nxjerrjen e vajit dhe fluideve tjerë, të cilët me kujdes të veçant deponohen në enë adekuate dhe dërgohen në rezervuaret përkatës për llojin e vajit dhe fluideve. Pasi të zhvendoset filtri i vajit nga automjeti sigurohet që vaji kullohet prej tyre dhe vendoset në enë të përshtatshme, si mbeturinë e rrezikshme në kontinier të posaçëm për filtra. Vaji vendoset në enë adekuate që shënohet në etiketë me shënimet e nevojshme për vajrat. Pastaj automjeti dërgohet në platformën/hapësirën ku bëhet çmontimi i pjesëve të përdorshme (pjesët që përdorën si pjesë rezervë), dhe të cilat magazinohen të klasifikuara në hapësirën që është e dedikuar për magazinimin e pjesëve të çmontuara që |

| | | |
|---|---|---|
| | | përdoren si pjesë rezervë, për montim ne automjetet e përdorshme. Pjesa tjetër e mbetur e automjetit dërgohet në platformën në të cilën kryhet çmontimi i pjesëve jo metalike (plastika, qelqi, lëkura, tekstili, druri,). Pas kryerjes së këtyre veprimeve mbetja e automjetit është krejtësisht me përbërje metali, dhe atë si mbeturinë metalike e cila i nënshtrohet prerjës, prerja e materialit në kompleksin e kësaj qendre bëhet me sharrë dore me flakë dhe me metoda tjera mekanike, apo me presa hidraulike. Prerja me dorë nënkupton prerjen me sharrë, me gërsher dhe me prerje elektrike. Prerja me flake nënkupton prerjen përmes djegëjes me oksigjen, acitilen apo propan-butan, presa hidraulike nënkupton makineri të posaçme për prerje të metaleve, më tutje mbeturina metalike kalon në presim (ballim) për të bërë zvogëlimin e vëllimit të mbeturinës metalike për llogari ekonomike dhe të transportimit të mëtutjeshëm. Presimi bëhet në presën hidraulike e cila është e përshtatshme për përdorim, manipulim dhe transport brenda kompleksit të qendrës.<br>Hapësira ku është e vendosur makina për presimin e veturave mbeturinë, është e rrethuar dhe mbuluar me beton poashtu ka të instaluar edhe sitemin për grumbullimin e ujërave atmosferike, të cilat pastaj grumbullohen në rezervuarin/seperatorin për pastrimin e ujit para se ai të shkarkohet.<br>Depo për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të lartëcekura posedon:<br>- Sipërfaqet gjelbëruese në pjesën perëndimore<br>- Sistemin për mbrojtjen nga zjarri<br>- Një Peshore me kapacitet 60 ton dhe dy peshore 500 kg për matjen e mbeturinave metalike Makinerinë e nevojshme për punë duke filluar nga:<br>- Auto Krani për bartjen e automjeteve mbeturinë<br>- Makinen hidraolike- presa disa copa |

| | | |
|---|---|---|
| | | - Paisjet për ngarkim shkarkim<br>- Kamjonet për transportim<br>- Kompresori – me kapacitet prej 1000 litra<br>- Të gjitha veglat e punës duke filluar nga çelsat të gjitha llojet, danta, turielat etj.<br> <br>  |
| 3.1.3. | Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve | Hënë - Premte<br>Orari i punës 08:00 – 17:00<br>E shtunë<br>Orari i punës 08:00 - 14:00 |

| | | |
|---|---|---|
| 3.1.4. | Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor. | Kapaciteti i projektuar është 60 deri në 100 $m^3$/ditë, njëherit ky është edhe kapaciteti i realizuar i prodhimit për një ditë të zakonshme pune, ndërsa rreth 2400 ton në muaj dhe rreth 25,400 ton në vit. |
| 3.1.5. | Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse. | Komponentët hyrëse në procesin e aktiviteteve që zhvillohen në Depon për grumbullimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të mbeturinave të lartëcekura janë:<br><br>Materialet që përdoren<br>o Mbeturinat metalike,<br>o Alumini,<br>o Inoks,<br>o Bakër,<br>o Plastikë,<br>o Elektro-mbeturina<br>o Vaj motorik të përdorur (mbeturinë),<br>o Akumulatorë mbeturin,<br>o Uji i cili merret nga pusi personal<br>o Energjia elektrike<br>o Nafta e cila mbahet në rezervuar dhe perdoret per nevojat e kompanisë |
| 3.1.6. | Lista e rezervuarëve dhe kapaciteti i tyre | 1 – seperator/rezervuar me dimensione 12 x 4.5m dhe thellësi 2m,<br>3 - rezervuar me nga 1000 litra vaj dhe fluide tjera,<br>1 – rezervuar me vëllim 10.000 litra për naftë |
| 3.1.7. | Lista e legjislacionit ne fuqi | **Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative për kompletimin e kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore.**<br>**Ligjet:**<br>• Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025<br>• Ligji për VNM Ligji Nr. 08/L-181<br>• Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025.<br>• Ligji për mbeturina Nr.08/L-071 për plotësim ndryshimin e ligjit për mbeturina Nr. 04/L- 60.<br>• Ligji Nr. 03/L-138 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174<br>• Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110<br>• Ligji nr. 08/l-112 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/l-26 për tokën bujqësore<br>• Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233<br>• Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147<br>• Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11<br>• Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197<br>• Ligji nr. 08/l-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-197 për kimikate<br>• Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025<br>• Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102<br>• Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012<br>**Udhëzimet Administrative:**<br>• Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit Administrativ (Mmphi) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore<br>• Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore<br>• Udhzimi adminstrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujorë.<br>• Udhzimi administrativ (QRK) Nr. 03/2021 për Menaxhimin e mbeturinave të Rrezikshme.<br>• Udhzimi administrativ (QRK) Nr. 08/2017 për menaxhimin e deponive  të Mbeturinave.<br>• Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2013 Për katalogun Shtetrorë të Mbeturinave |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Udhëzimi administrativ për menaxhimin e automjeteve mbeturinë, komponentët e tyre dhe mbeturinave metalike Nr.19/2012.<br>• Udhëzimi administrativ Nr 26/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët<br>• Udhëzimi Administrativ (QRT) Nr. 07/2021 për rregulloret dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.<br>• Udhzimi administrative (Ligji Nr. 04 /L-230), AME-Axhensioni për Menaxhimin e Emerxhencave-MPB.<br>• Udhëzim Administrativ (MMPH) Nr 09/2014 Licenca Për Menaxhimin E Mbeturinave.<br>• Udhëzimi administrativ Nr. 20/2012 për export, import dhe transit të mbeturinave.<br>• Udhëzimi administrativ për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinat me vajra Nr.05/2013.<br>• Udhëzimi administrativ Nr 23/2012 për menaxhimin e gomave jashtë përdorimit dhe mbeturinat e gomës<br>• Udhëzimi administrativ kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave (08/2 Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme<br>• Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për metodologjinë e zvoglimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat per eliminimin e pasojave. |

| 3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit | | |
|---|---|---|
| 3.2.1. | Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit | Kompania “Trimi Metal” shpk e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të lartëcekura në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm.<br>Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim:<br>- Përmirësimin e vazhdueshëm i Mjedisit<br>- Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit<br>- Respektimin e legjislacionit vendor në fuqi<br>- Përmirësimin e komunikimit me autoritetet |
| 3.2.2. | Raportimi | ///// |

| 4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE | | |
|---|---|---|
| 4.1. | Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse | Në kompaninë “Trimi Metal” shpk e cila si aktivitet ka mbledhjen grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipa kodeve të lartëcekura në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit<br>Pika të burimit të emisioneve mund të jenë:<br>• Pluhurat të cilët lirohen nga automjetet e transportit dhe ngarkimi-shkarkimit të mbeturinave metalike.<br>• Pluhurat që lirohen gjatë procesit të çmontimit dhe klasifikimit të pjesëve.<br>• Pluhurat të cilët lirohen gjatë presimit, prerjës dhe vëndosjes së pjesëve në kontinjerë për deponim të tyre. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operacionale që ndodhën në atë lokacion.<br>• Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e transportit, apo gjeneratorët, etj. |
| 4.2 | Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit | Gjatë funksionimit kontinuel të kompanisë "Trimi Metal" shpk e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të lartëcekura në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, mund të theksojmë se aktiviteti i këtij kompleksi nuk shoqërohet me ndotje të theksuar të ajrit, e vetmja ndotje mund të ndodh nga automjetet transportuese që transportojnë automjetet mbeturinë dhe komponentët e tyre, si dhe mbeturinat metalike në këtë deponi, nga automjetet transportuese që transportojnë pjesë të çmontuara të automjeteve mbeturinë siç janë mbeturinat metalike, akumulatorët mbeturinë, alumin, inoks, bakër, plastikë, elektrombeturina si dhe vaj motorik mbeturinë e fluide tjera mbeturinë, si dhe nga automjetet tjera që qarkullojnë në këtë lokalitet. |
| 4.3. | Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse | Gazrat nga djegjet motorike përmbajnë një numër të madh të komponenteve ndotëse me koncentracione të ndryshme, por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, $S0_2$ dhe Pb. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin në fjalë. |
| 4.4. | Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese | Nuk ka |
| 4.5. | Pajisjet për de-pluhurin | Sperkatje me ujë të siperfaqeve manipuluse. |
| 4.6. | Monitorimi i emisioneve | Nuk bëhet |
| 4.7. | Monitorimi i emisioneve/ cilësisë ë ajrit | Nuk bëhet |
| 4.8. | Raportimet | // |

| | | |
|---|---|---|
| 4.9. | Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit | Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës të zhvillimit të aktiviteteve të mbledhjes, grumbullimit, magazinimit dhe trajtimit fizik të mbeturinave sipas kodeve të lartëcekura, bëhet kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese (pirunëve) dhe transportuese që konsumojnë lëndë të lëngeta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetët e punës të jetë sa më kualitativ. Në hapësirat e kompanisë “Trimi Metal” shpk e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të lartëcekura me qëllim të eliminimit të erërave të ndryshme në disa raste gjatë dimirt bëhet aktivizimi i ventilatorëve, me qëllim që të bëhet ventilimi i hapësirave punuese, prandaj në njërën anë të murit të vendosen ventilatorët me biofiltër për pastrimin e ajrit, kurse në anën tjetër të murit të vendosen hapjet për hyrjen e sasisë së ajrit të pastër aq sa është nxjerrur me anë të ventilatorëve, gjithashtu aroma e pakëndshme zvogëlohet përmes ajrimit artificial përmes dritareve të vendosura në objekt. Bëhet kontrollimi i rregullt i pajisjeve për trajtimin e erërave dhe sistemit të ventilimit, pjesët e dëmtuara ndërrohen.<br>Poashtu gjatë sezonit të verës vazhdimisht bëhet sperkatja e sipërfaqeve manipuluese, me qëllim zvogëlim r sasisë së pluhurit që ngritet në ajër. |
| 4.10. | Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike | Për të zvogëluar ndikimet në ndryshimet klimatike gjatë funksionimit të një deponie që merret me mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave metalike, është e domosdoshme zbatimi i një sërë masash që përfshijnë, ndërtimin e infrastrukturës me efikasitet energjetik dhe përdorimin e energjisë së ripërtëritshme. Të përdoren mjete dhe pajisje me konsum të ulët karburanti ose me motorë elektrikë, të optimizohet logjistika për të reduktuar emetimet dhe të shmanget djegia e mbeturinave në vend. Ndikimet klimatike mund të minimizohen më tej përmes ndarjes dhe trajtimit të kontrolluar të mbetjeve, ruajtjes së tyre në kushte të sigurta për të parandaluar ndotjen e tokës dhe ujërave, si dhe instalimit të sistemeve për monitorimin e |

| | | |
|---|---|---|
| | | ndotjes së ajrit dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Gjithashtu, është thelbësore të rritet niveli i riciklimit dhe efikasiteti në përdorimin e burimeve, të ofrohen trajnime për stafin për menaxhim të qëndrueshëm dhe të përgatiten raporte të rregullta mbi ndikimin mjedisor në përputhje me standardet ndërkombëtare të menaxhimit të mjedisit. |

| **5. UJI** | | |
|---|---|---|
| 5.1. | Të dhënat për shfrytëzimin e ujit | Uji përdoret në sasi të vogël, uji nuk përdoret për procesin teknologjik apo për ndonjë aktivitet tjetër që përfshin procesin e punës në këtë deponi, përveç ujërave të sanitaris, larjës dhe të spërkatjës të sipërfaqeve operacionale. Uji merret nga pusi privat i hapur nga kompania.  |
| 5.2. | Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit | Kompania posedon sisteme për trajtimin e ujrave dhe seperator të ujërave atmosferike dhe të cilët grubullohen dhe ndahen nga ndonjë sasi e vajrave dhe grimcave të ngurta që mund të ketë rrjedhur nga sipërfaqja e jashtme. Këto ujëra nga separatorët asnjëherë lëshohen në recipient apo derdhen në trupin ujorë pa u trajtuar nëse përmbajnë |

| | | |
|---|---|---|
| | | vajra dhe yndyrna mbi vlerat e përcaktuara me Udhzimi adminstrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujorë. Kështu që mundësia që ujërat e ndotura të shkarkohen në trupin e ujërave nëntokësorë është i vogël. |
| 5.3. | Ndikimet në ujë | Ekziston një rrezik potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore gjatë funksionimit të vazhdueshëm të deponisë, e cila ka për aktivitet mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të përmendura më herët.<br>Ky rrezik mund të paraqitet si rezultat i:<br>• ujërave të reshjeve atmosferike që bien mbi sipërfaqet e pambuluara ku janë të vendosura mbeturinat metalike,<br>• zhvendosjes, grumbullimit dhe magazinimit të karburanteve, vajit të motorit, vajit të kutisë së shpejtësisë, vajit të transmisionit, vajit hidraulik, lëngjeve ftohëse, fluideve të frenimit, acideve të akumulatorëve, fluideve të sistemit të klimatizimit dhe lëngjeve të tjera që gjenden në automjetet e vjetra të deponuara,<br>• si dhe nga rezervuarët ku këto fluide janë të ruajtura,<br>• dhe nga ujërat që krijohen gjatë larjes së hapësirave ku ndodhen mbeturinat metalike.<br>Këto ujëra zakonisht janë të turbullta dhe përmbajnë yndyrë, si dhe ndotës të tjerë, varësisht nga përbërja e mbeturinave metalike të përmendura më parë. Për shkak të ndikimit potencial që ato mund të kenë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, është ndërtuar një impiant për trajtimin e ujërave të ndotura. |
| 5.4. | Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor | Nuk gjeneron ndotje të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, pasi që uji i cili përdorët për ketë veprimtari është në sasi shumë të vogël dhe kryesisht vije nga nevojet sanitare të punëtorve, për larje dhe ujërat për sperkatjen e sipërfaqeve manipuluese. |

| | | |
|---|---|---|
| 5.5. | Trajtimi i ujërave të ndotura | Kompania ka të ndërtuar impiantin/seperatorin të ujërave atmosferike/sipërfaqsore dhe të cilët grubullohen dhe ndahen nga ndonjë sasi e vajrave apo grimcave të ngurta që mund të ketë rrjedhur nga sipërfaqja e jashtme operacionale. Këto ujëra nga separatorët asnjëherë nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në trupin ujorë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyrna mbi vlerat e përcaktuara me ligj.  |
| 5.6. | Kontrolli dhe matjet | Kompania “Trimi Metal” shpk e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të lartëcekura në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, nuk bënë matje dhe kontrollim të ujërave. |
| 5.7. | Raportimi | Nuk bënë raportime. |
| 5.8. | Leje ujorë për shfrytëzim të ujit | Nuk posedon leje për shfrytëzim të ujit. |
| 5.9. | Leje ujorë shkarkimin e ujërave | Nuk posedon leje për shkarkim të ujit. |
| 5.10. | Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave | Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet negative në ujë, janë ndërmarrë këto masa mbrojtëse: |

| | | |
|---|---|---|
| | | Janë ndërtuar kolektorët dhe sistemi i gypave për mbledhjen dhe bartjen e ujërave të ndotura nga të gjitha sipërfaqet operacionale të deponisë. Po ashtu, ky sistem mbulon sipërfaqet operacionale të hapësirave të nevojshme për çmontimin e pjesëve rezervë të automjeteve, përfshirë edhe kanalet ku mund të rrjedhin vajrat, derivatet dhe lëngjet e tjera që përmbajnë automjetet.<br>Gjithashtu, përfshihen sipërfaqet operacionale të destinuara për magazinimin e pjesëve metalike të çmontuara dhe automjeteve, si dhe zonat e depos apo magazinës ku janë vendosur enët apo rezervuarët për ruajtjen e ndarë të fluideve të automjeteve të hedhura. Këto përfshijnë: karburantët, vajin e motorit, vajin e kutisë së shpejtësisë, vajin e transmisionit, vajin hidraulik, lëngjet ftohëse, fluidet e frenimit, acidet e akumulatorëve, lëngjet e sistemit të klimatizimit dhe fluide të tjera që gjenden në automjetet që duhet të çmontohen.<br>Të gjitha këto ujëra të ndotura dërgohen për trajtim në separator të posaçëm për pastrimin e ujërave nga derivatet dhe mbeturinat e tjera të lëngëta, të cilat gjenerohen gjatë aktiviteteve të deponisw sw mbeturinave metalike. Pas trajtimit, ujërat e pastruara në separator mund të lëshohen në recipientin përkatës.<br>Në vazhdimësi bëhet grumbullimi dhe sedimentimi i ujërave sipërfaqësorë që rrjedhin nga platoja në sipërfaqet e deponisë - magazinës dhe të dërgohen në seperator për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat. Seperatori i vajërave përmës mureve në disnivele e bënë ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura dhe i deponon në pusetën e posaçme, ku pas mbushjes së pusetës të pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e seperatorëve dhe gropave septike. Seperatori përmbush kriteret teknike që janë të parapara me rregullore dhe normative në fuqi. Ujërat nga separatori nuk lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë derivate të naftës mbi 1 mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30 mg/l në ujë. Seperatori i vajrave rregullisht |

pastrohet nga pronari apo kompanitë e licencuara. Kompania “Trimi Metal” shpk në depon për grumbullimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit nuk bënë ndonjë trajtim i akumulatorëve, por në rast aksidenit, rekomandohet të ndërtoj vaskën për neutralizimin e acideve me kapacitet prej 1 $m^3$, neutralizimi të bëhet me hidroksid natriumi, pastaj acidi i neutralizuar me pH rreth 7 deponohet në fuqinë përkatëse (kjo vlenë vetëm në rast të dëmtimit të ndonjë akumulatori). Gjatë funksionimit të depos për grumbullimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave, pronari i kompanisë duhet të vazhdojë të bëj matjen e cilësisë së ujërave të shkarkuara, vlerat e fituara të krahasohen dhe nuk guxojnë të jenë më të larta se vlerat e caktuara sipas Udhezimit administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trup ujorë dhe në rrjetin e kanalizimit publik (13/2008) dhe normave të caktuara nga legjislacioni i BE. Rezultatet e fituara dorëzohen në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, intervali i matjeve kryhet në bazë të përcaktimit me aktet ligjore dhe në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.




***Fig. 5. Skema teknologjike e trajtimit të ujërave***

Madhësia dhe dimensioni i seperatorit është përcaktuar në bazë të sasisë së ujërave që duhet trajtuar dhe në bazë të numrit të cikleve për grumbullimin e mbeturinave metalike, vajrave të përdorura, si dhe mbeturinat nga pajisjet elektrike gjatë ditës.

| | | |
|---|---|---|
| | | Ujërat e zeza nuk trajtohen në gropën septike, por lirohen direkt në rrejtin e kanalizimit. |

<table>
<tr><th colspan="3">6. ZHURMA</th></tr>
<tr><td>6.1.</td><td>Burimet</td><td>
Lokacioni i kompleksit të deponisë e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të lartëcekura është i ekspozuar zhurmës se krijuar nga:<br>
Grumbullimi i pjesëve të automjeteve mbeturinë,<br>
Çmontimi i pjesëve të automjeteve mbeturinë,<br>
Prerja e pjesëve metalike dhe komponentët e tyre,<br>
Presimi i pjesëve metalike dhe komponentët e tyre,<br>
Deponimi i pjesëve metalike në kontinjer të caktuar,<br>
Qarkullimi i automjeteve transportuese, etj.<br>
Me shfrytëzimin e pajisjeve punuse në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim është 75 dB ndersa duke shkuar me ne largesi niveli i zhurmes shkon duke rene.<br>
Niveli i zhurmës për zonat e banuara në bazë të standardeve ndërkombëtare është i caktuar 50 dB për kohën gjatë ditës, kurse gjatë natës niveli i zhurmës duhet të jetë max. 45 dB.<br>
Sipas gjendjes faktike të kompleksit të deponisë e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të lartëcekura në lokacionin e analizuar mund të konstatojmë se niveli zhurmës do të jetë në nivelin e vlerave të lejuara. Në vijim po e paraqesim në formë tabelore nivelin e zhurmës:
<table>
<tr><td rowspan="2">Zhurma</td><td colspan="4">Distanca (m)</td></tr>
<tr><td>10</td><td>50</td><td>100</td><td>500</td></tr>
<tr><td>90db –niveli Për pajisje moderne</td><td>59</td><td>45</td><td>39</td><td>25</td></tr>
</table>
Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e objekteve të banimit si dhe kapacitetin dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojitën për bartjen e mbeturinave, si dhe
</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | | duke pasur parasysh se deponia e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të lartëcekura, ka hapësirat e mbyllura ku janë të vëndosura makinerit punuese, prandaj mund të konkludojm se ky impiant për trajtimin e mbeturinave metalike në aspektin e zhurmës nuk do të ketë ndikime negative të mëdha në aktivitetet tjera që veprojnë në ketë lokalitet. |
| 6.2. | Kontrolli dhe matjet | Nuk bënë matje dhe kontrollim të zhurmës. |
| 6.3. | Raportimet | //// |

| **7. TOKA** | | |
|---|---|---|
| 7.1 . | Ndikimet në tokë | Gjatë funksionimit të vazhdueshëm të kompanisë “TRIMI METAL” SH.P.K., e cila merret me mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të përmendura më herët, ndotja e dheut paraqet një shqetësim të vazhdueshëm.<br>Kjo ndotje ndodh si pasojë e grumbullimit të mbeturinave metalike dhe pjesëve të çmontuara nga automjetet e hedhura, të cilat përfshijnë: goma, akumulatorë, pjesë metalike dhe jo-metalike (si qelqi, plastika etj.), vajra motorikë, pjesë elektronike dhe të ngjashme.<br>Një tjetër burim i ndotjes është sedimentimi i ndotësve të transportuar nga ujërat sipërfaqësore që rrjedhin nga sipërfaqet operacionale të kompleksit të deponisë dhe objekteve përreth, të nevojshme për funksionimin e saj. Gjithashtu, ndotja ndodh edhe përmes grimcave ndotëse të cilat depozitohen nga ajri në formë të fundërrimeve.<br>Kjo përbën një ndotje sistematike të dheut, e cila zhvillohet gjatë funksionimit normal të kompleksit. Përveç kësaj, mund të ndodhë edhe ndotja aksidentale, si pasojë e derdhjeve të pakontrolluara të |

| | | |
|---|---|---|
| | | derivateve dhe lëngjeve të tjera të rrezikshme që gjenden brenda automjeteve të vjetra të deponuara.<br>Në raste të tilla, mënyra e vetme për të shmangur ndikimet mjedisore është largimi i dheut të kontaminuar dhe transportimi i tij në deponi të autorizuara dhe të sigurta për mjedisin.<br>Nga të gjitha këto të dhëna, kuptohet se ndotja e dheut në afërsi të kompleksit varet kryesisht nga:<br>• rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqet manipuluese të kompleksit, dhe<br>• konfiguracioni i terrenit në zonën përreth. |
| 7.2. | Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë | Për të parandaluar ose minimizuar ndotjen e tokës gjatë aktivitetit të kompanisë, janë ndërmarrë këto masa mbrojtëse:<br>• **Betonimi i sipërfaqeve**: Platoja ku vendosen mbeturinat metalike dhe automjetet e hedhura është betonuar për të parandaluar depërtimin e derivateve dhe fluideve në tokë. Gjithashtu, janë instaluar gypa për mbledhjen e ujërave atmosferike dhe ujërave nga shpëlarja.<br>• **Çmontimi në hapësira të kontrolluara**: Procesi i çmontimit të pjesëve të automjeteve realizohet në hapësira të mbyllura. Aktivitetet që mund të shkaktojnë rrjedhje fluide zhvillohen në kanale të ndërtuara dhe të izoluara, të pajisura me sistem gypash që çojnë drejt separatorëve të vajrave.<br>• **Nxjerrja dhe depozitimi i fluideve**: Vaji, derivatet dhe fluidet e tjera që përmbajnë automjetet hiqen në një hapësirë të veçantë, për të shmangur kontaktin me tokën, dhe depozitohen në rezervuarë të dedikuar për këtë qëllim.<br>• **Menaxhimi i akumulatorëve**: Akumulatorët nuk çmontohen, por vetëm grumbullohen, paketohen dhe ruhen në hapësira të mbyllura. Më pas, ato dërgohen për shitje tek kompani të licencuara. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • **Magazinimi i pjesëve të çmontuara**: Janë ndërtuar objekte të posaçme për magazinimin e pjesëve të automjeteve dhe mbeturinave metalike, të pajisura me rafte dhe hapësira të mbuluara e të betonuar. Pjesët metalike (bakër, alumin, magnez etj.), pjesët elektronike, komponentët e sistemit të klimatizimit dhe katalizatorët ruhen dhe klasifikohen sipas llojit. Edhe pjesët jo-metalike si plastika dhe qelqi depozitohen në kontejnerë të posaçëm.<br>• **Përdorimi i kontejnerëve të përshtatshëm**: Filtrat dhe mbeturinat tjera të ngurta që nuk trajtohen më tej ruhen në kontejnerë të posaçëm të vendosur brenda objekteve.<br>• **Depozitimi i lëngjeve të automjeteve**: Janë siguruar enë dhe rezervuarë për depozitimin e ndarë të karburantëve, vajrave të ndryshëm (motori, kutia e shpejtësisë, transmisioni, hidraulik), lëngjeve ftohëse dhe fluideve të frenimit. Këto rezervuarë janë vendosur në sipërfaqe të betonuar dhe të izoluar për të shmangur ndotjen e tokës.<br>• **Menaxhimi i gomave**: Gomat ruhen në anekse të veçanta për të minimizuar rrezikun nga zjarri.<br>• **Grumbullimi i mbeturinave të ngurta**: Mbeturinat që nuk trajtohen më tej, përfshirë mbeturinat komunale, vendosen në kontejnerë të posaçëm me kapak. Ato transportohen përmes mjeteve vetanake ose nga ndërmarrje të licencuara për menaxhimin e mbeturinave, dhe dërgohen në deponinë e qytetit. |

| | | |
|---|---|---|
| | |  |
| 7.3. | Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit | Pas përfundimit të jetë gjatësisë së deponisë e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve të lartëcekura, kjo varet nga pronari i kompanisë "TRIMI METAL" SH.P.K. se edhe sa do të vazhdoj me këtë aktivitet.<br>Fillimisht të gjitha makinat e përdorura në këtë aktivitet do të shiten apo të dergohën në deponit të caktuara për grumbullimin e tyre, pastaj të gjitha materialet e mbeturinave metalike do të shiten apo të dorëzohen në kompani të licencuara. Objektet ekzistuese do të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platot nga betoni do të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponinë regjionale. Të gjitha mbetjet e mbeturinave të ngurta dhe ato të inerteve qe ekzistojnë në siperfaqet e lokacionit, si shtresa e dheut të kontaminuar etj, pa tjetër duhet të largohen dhe të bëhet zavendesimi i tyre me një shtresë të humusit prej 0,5 m trashesi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të behet ngjeshja e kesaj shtrese të humusit (dheut) me qellimë qe të jetë shtresa ma kompaktë, ashtu qe të krijohet nje substrat produktiv i pershtatshemë per rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të |

| | | |
|---|---|---|
| | | dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëlliml i rekultivimit i cili nënkupton sipërfaqet e degraduara, prap të kthehen në funksion të tyre primar (prodhimi i biomasës), të kthehet në gjendje të përafert me ambientin rrethues dhe të mbjellen të lashtat periodike bujqore të cilat kultivohen në rrethinën e lokalitetit, dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem. |

**8. MENAXHIMI I MBETURINAVE**

| | | |
|---|---|---|
| 8.1. | Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave | Gjatë funksionimit kontinual të kompanisë "TRIMI METAL" Shpk, e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave me kodet e lartëcekura, dhe ka të bëjë me këto lloje të mbeturinave: mbeturina të ndryshme metalike, pjesë të çmontuara nga automjetet mbeturinë të cilat janë: gomat, akumulatorët, pjesët metalike, pjesët jo metalike (qelqi, plastika,...), pjesët elektronike, etj. Pastaj, mbeturinat tjera metalike, hekur, alumin, inoks, bakër, plastikë, elektrombeturina si dhe vaj motorik mbeturinë, etj.<br>***Më poshtë gjeni listen e mbeturinave sipas katologut shtetëror të mbeturinave, që përfshinë aktiviteti i kompanisë "Trimi Metal" shpk, në zonën kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit.*** |

| **Kodet sipas UA 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave** | **Përshkrimi i llojit të mbeturinave** |
|---|---|
| **13 01 01*** | ***Vajrat hidraulike, që përmbajnë PCB*** |
| **13 02 04*** | ***Vajëra motori ingrinazhesh dhe lubrifikant të kloriuar me bazë minerale*** |
| **13 02 05*** | ***Vajra motori ingranazhesh/dhëmbëzorët dhe lubrifikues të pa kloruar me bazë minerale*** |
| **13 02 06*** | ***Vaj sintetik motori, ingranazhesh/dhëmbëzori dhe lubrifikues*** |
| **13 02 07*** | ***Vajra lehtësisht të biodegradueshëm; motori, ingranazha dhe lubrifikant*** |
| **13 02 08*** | ***Vajra tjera motori, ingranazhi dhe lubrifikante*** |
| **13 05 02*** | ***Llumrat nga ndarja ujë/vaj*** |
| **15 01 04** | ***Ambalazhe Metalike*** |
| **15 01 06** | ***Ambalazhe të përziera*** |
| **16 01 03** | ***Gomat e vjetra*** |
| **16 01 04*** | ***Automjetet e vjetra*** |
| **16 01 06** | ***Automjetet jashtë përdorimit që nuk përmbajnë lëngje apo komponente tjera të rrezikshme*** |
| **16 01 07*** | ***Filtra vaji*** |
| **16 01 13*** | ***Lëngje frenash*** |
| **16 01 19** | ***Plastika*** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **16 02 11*** | ***Paisjet për hudhje që përmbajnë kloroflorokarbone*** |
| | | **16 06 01*** | ***Bateritë e plumbit*** |
| | | **16 06 02*** | ***Bateritë Ni-Cd*** |
| | | **16 06 05** | ***Baterit dhe akumulatorët tjerë*** |
| | | **16 06 06*** | ***Elektrolitet nga baterit dhe akumulatorët e mbushur pas ndasjës*** |
| | | **16 08 01** | ***Katalizatorët e hargjuar që kanë ar, argjend, renium, radium, paladium, iridium ose platinium (përveç 160807)*** |
| | | **17 02 02** | ***Qelqi*** |
| | | **17 02 03** | ***Plastika*** |
| | | **17 04 01** | ***Bakri, bronzi, tunxhi*** |
| | | **17 04 02** | ***Alumini*** |
| | | **17 04 03** | ***Plumbi*** |
| | | **17 04 04** | ***Zinku*** |
| | | **17 04 05** | ***Hekuri dhe çeliku*** |
| | | **17 04 06** | ***Kallaji*** |
| | | **17 04 07** | ***Metalet e përziera*** |
| | | **19 10 01** | ***Mbeturinat e hekurit dhe çelikut*** |
| | | **19 10 02** | ***Mbeturinat të metaleve të ngjyrosura*** |
| | | **20 01 01** | ***Letër dhe karton*** |
| | | **20 01 23*** | ***Pajisjet për hudhje që përmbajnë kloroflorokarbonë*** |
| | | **20 01 33*** | ***Baterit dhe akumulatorët e përfshir në 16 06 01, 16 06 02 dhe 16 06 03 dhe baterit dhe akumulatorët e pandarë*** |
| | | **20 01 34** | ***Baterit dhe akumulatorët tjetë nga ata të paraqitura në 20 01 33*** |
| | | **20 01 35*** | ***Pajisje elektrike dhe elektronike për hudhje tjera nga ato të përmendura në 200121 dhe 200123 që përmbajnë komponente të rrezikshme*** |
| | | **20 01 36** | ***Paisjet elektrike dhe elektronike për hudhje, tjera nga ato të përmendura në 20 01 21, 20 01 23 dhe 20 01 35*** |
| 8.2. | Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave | Për administrimin dhe menaxhimin sa me të mirë në ketë kompleks të deponisë grumbulluese dhe çmontuese të mbeturinave metalike kryhen këto veprime: grumbullimi, çmontimi, klasifikimi, magazinimi, prerja, ballimi (shtypja), ambalazhim, deponim, etj, si në vijim. Grumbullimi bëhet duke i transportuar mbeturinat metalike deri tek peshorja, pastaj futen në repartin për klasifikim sipas materialit dhe gjendjes fizike të materialit. Materiali i | |

| | | |
|---|---|---|
| | | klasifikur sipas nevojës presohet ose copëtohet në pjesë të imëta për të deponuar në kontejner, thas ose paleta të caktuara për shitje tek kompanit e licencuara. Në rastet kur vijnë automjetet mbeturinë atëherë ndiqet kjo rregull: Automjetet e demoluara pas peshimit sillen gjerë te platoja për vendosjen e automjeteve, pastaj automjetet dërgohen në vendin ku kryhet largimi nga automjeti i derivateve, gomave dhe akumulatorëve. Derivatet deponohen në rezervarët e posaçëm, akumulatorët dhe gomat magazinohen në hapësirat e përshtatshme gjerë në shitjen e tyre tek kompanit e licencuara. Pastaj automjeti dërgohet në hapësirën për nxjerrjen e vajit dhe fluideve tjerë, të cilët me kujdes të veçanet deponohen në enë adekuate (rezervuar) dhe dërgohen tek kompanit e licencuara për grumbullimin e tyre. Pasi të zhvendoset filtri i vajit nga automjeti sigurohet që vaji të kullohet prej tyre dhe të vendoset në enë të përshtatshme. Enët e përdorura për deponimin e vajrave jenë të mbyllura në çdo kohë, filtri pasi te kullohet vendoset si mbeturinë e rrezikshme në kontinier të posaçëm për filtra. Pastaj automjeti dërgohet në platformën/hapësirën ku bëhet çmontimi i pjesëve të përdorshme (pjesët që përdorën si pjesë rezervë), dhe të cilat magazinohen të klasifikuara në hapësirën që është e dedikuar për magazinimin e pjesëve të çmontuara që përdoren si pjesë rezervë, për montim ne automjetet e përdorshme. Pjesa tjetër e mbetur e automjetit dërgohet në platformën në të cilën kryhet çmontimi i pjesëve jo metalike (plastika, qelqi, lëkura, tekstili, druri,...).<br>Objektet për vendosjen e mbeturinave metalike, akumulatorëve mbeturin, alumin, inoks, bakër, plastikë, elektrombeturina si dhe vaj motorik mbeturinë e fluide tjera mbeturin, janë objekte përdhes, të ndërtuar prej konstruksionit metalik i rrethuar dhe mbuluar nga llamarina e plastifikuar, baza e të cilit është e betonuar dhe jo lëshuese për lëngjet në tokë, në të cilën janë të vendosura |

| | | |
|---|---|---|
| | | raftet, paletat apo thasët ku bëhet vendosja e pjesëve sipas klasifikimit të tyre. Baterit e automjeteve vendosen në paleta mbështjellen me najllon dhe deponohen në hapësirat brenda objektit deri në momentin e dorezimit tek kompanit e licencuara. Vaji i motorit vendoset ne rezervuar i cili poashtu deponohet deri në momentin e dorezimit tek kompanit e licencuara. |
| 8.3. | Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave | Pas kryerjes së veprimeve nga pika 8.2 pjesa e mbetur e automjetit është krejtësisht me përbërje metali dhe atë si mbeturin metalike e cila duhet prerë, prerja e materialit në kompleksin e kësaj deponie bëhet me prese hidaulike, sharrë dore me flakë dhe me metoda mekanike. Prerja me dorë nënkupton prerjen me sharrë, me gërsher dhe me prerje elektrike. Prerja me flake nënkupton prerjen përmes djegijes me oksigjen, acitilen apo propan-butan, më tutje mbeturina metalike kalon në presim (ballim) për të bërë zvogëlimin e vëllimit të mbeturinës metalike për llogari ekonomike dhe të transportimit më të lehtë gjer te pajimet për përpunim të mëtutjeshëm. Presimi bëhet në presën hidraulike e cila është e përshtatshme për përdorim, manipulim dhe transport brenda kompleksit të qendrës.<br>Kompania "TRIMI METAL" Shpk, e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave kompania në fjalë nuk bënë riciklimin e asnjë lloji të këtyre mbeturinave. |
| 8.4. | Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër-kontratë me kompaninë me leje përkatëse | Pas fazës së çmontimit, klasifikimit dhe deponimit në depo, tregohet kujdes në manipulimin me akumulatorë, motora të makinave të cilat vendosen në pjesën e mbuluar të platosë me bazë betoni e cila është e betonuar dhe izoluar me material jopershkues. Akumulatorët dhe pjesët tjera si të ambalazhuara në paleta qëndrojnë në depo deri atëherë kur mirën nga kompanitë e licencuar për riciklimin e tyre. |

| | | |
|---|---|---|
| | | Faza e ndarjes së metaleve nga plastika përsëritet me kujdes te veçantë, kontrolli i pjesëve ose grimcave të plastikës që eventualisht kanë mbetur ende me pjesët metalike. Për këtë qëllim është instaluar transportuesi me magnet, ose tavolina me sipërfaqe të madhe, ku bëhet kontrolli i kujdesshëm. Pas ndarjes së pjesëve metalike nga pjesët plastike, atëherë ato ndaras ambalazhohen dhe vendosen ne hapësirat adekuate gjerë sa të transportohen nga blerësi i licencuar.<br>Vajrat, filtrat e vajrave dhe katalizatorët konsiderohen si material i rrezikshëm për mjedisin vendosen në separator/rezervuar apo kontinjer të caktuar ambalazhohen dhe qëndrojnë nën mbulojë, pastaj dërgohen në për trajtim sipas standardeve për trajtimin e tyre nga kompanit e licencuara për riciklim të tyre. |
| 8.5. | Plani për menaxhimin e mbeturinave | Gjatë funksionimit kontinual të kompanisë "TRIMI METAL" Shpk, e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave, bënë mbikeqyrje e rregullt dhe menaxhim të mirë gjatë grumbullimit të metaleve të ndryshme dhe çmontimit të automjeteve mbeturinë si dhe deponimin dhe ruajtjen e pjesëve të çmontuara dhe e pjesëve të seleksionuara.<br>• Për prerjen e metaleve me flakë të hapur përdoret një garniture e cila përbëhet nga një bomëbolë standarde për oksigjen dhe një me GLN, kjo garniturë kur nuk përdoret vendoset në depon - magazinën e veglave dhe mjeteve të punës,<br>• Nuk bëhet deponimi i pjesëve të çmontuara në mënyrë të pakontrolluar në hapësirat e kompleksit të qendrës.<br>• Nuk bëhet ndezja e mbeturinave të lëngta dhe të ngurta në lokacionin brenda kompleksit.<br>• Nuk realizohet çmontimi i elementeve të automjeteve qe në vete permëbajnë materie të lëngëta që konsiderohen materie të rrezikshme në hapësira të hapura dhe jo të betonuara. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Nuk bëhet deponimi i fluideve të automjeteve mbeturinë, në mënyrë të pakontrolluar në hapësirat e qendrës grumbulluese që nuk janë të dedikuar për deponimin e tyre.<br>• Rezervarët e vajrave dhe fluideve të automjeteve të hedhura janë të vendosur brenda objektit mbi një bazë metalike në formë te rezervuarit për kullimin e tyre në rast të derdhjes aksidentale. Kapaciteti i bazes metalike është konstruktuar ne atë mënyrë që ta zë tërë sasinë e fluideve nga rezervuari në rast aksidenti me qëllim të zvogëlimit të rrezikshmërisë në rast aksidenti.<br>• Është obligim që rezervaret e vajrave dhe fluideve të automjeteve mbeturinë të kontrollohen brenda 5 viteve të para të punës për të përcjellë demtimet e trashësisë së mureve nga veprimi korroziv, pas 5 viteve kontrolli bëhet për çdo dy vite. Prandaj kompania do ta realizoj shumë shpejtë.<br>• Punëtorët nuk përdorin materialin në punë gjatë prerjes me flakë, saldim etj, të atyre mbeturinave (gypave, enëve, radiatorëve, aparateve, etj) deri sa nuk konstatohet apo nuk pastrohen nga prania e materieve ndezëse apo eksploduese.<br>• Pronari mbanë evidencën dhe ruan shënimet për automjetet e grumbulluara dhe të çmontuara, mbeturinave metalike si dhe emrin dhe mbiemrin e personit nga i cili i ka marrë, etiketimin e komponenteve të cilat zhvendosen nga automjetet e vjetruara përmes çmontimit, me qëllim të ripërdorimit ose riciklimit të tyre, mbanë shënimet për sasinë e komponenteve të cilat janë shitur, për sasin e mbeturinave metalike të shitura, si dhe emrin e mbiemrin kujt ia kanë shitur, mbanë shenimet për sasinë e vajrave mbeturinë të grumbulluara dhe për dërgimin e tyre në qendrat e licencuara, për sasinë e akumulatorëve të çmontuar dhe për dërgimin e tyre në qendrat e riciklimit. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Evidenca dhe shenimet mbahen sipas rekomandimeve që jepen në Ligjin për Mbeturina Nr. 04/L-060 dhe Ligji për mbeturina Nr.08/L-071, Udhëzimit administrativ për menaxhimin e automjeteve mbeturinë dhe komponentet e tyre Nr.19/2012, Udhëzimit administrativ Nr. 26/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët, Udhëzimit administrativ për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinat me vajra Nr.05/2013, Udhëzimit administrativ Nr 23/2012 për menaxhimin e gomave jashtë përdorimit dhe mbeturinat e gomës, dhe Udhëzimeve administrative për mbeturina tjera relevante të hartuara sipas rekomandimeve nga Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 dhe Ligji për mbeturina Nr.08/L-071.<br>• Është hartuar rregullorja ku definohen procedurat për rastet aksidentale, bëhet aftësimi i të punësuarve dhe caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.<br>• Nuk është realizuar mbjellja e sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara dhe asfaltuara me barë dhe drunj dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me erëra kundërmuese dhe për çeshtje vizuale.<br>• Është thurur oborri i qendrës me rrethoj fizike në lartësi minimale 2.5 metra, ndërsa brenda rrethojes fizike nuk është krijuar muri prej drunjeve dekorativ.<br>• Rrethoja fizike e deponisë së mbeturinave metalike, nga aspekti vizuel nuk ka pamje të vrazhdë nga jashtë.<br>• Në mënyrë permanente mirëmbahet ambienti në kompleksin e deponisë së mbeturinave metalike. |
| 8.6. | Raportimi | Udheheqia, gjegjesisht ekspertët e kompanisë “TRIMI METAL” SH.P.K. se paku në fund të çdo viti kalendarik, do të vazhdojnë edhe metutje edhe pas marrjës së lejës mjedisore ti paraqitën të |

| | | |
|---|---|---|
| | | dhenat relevantë nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat i raportohen autoriteteve perkatëse sipas kerkeses se tyre, komunitetit lokal brenda komunës dhe në Ministri të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. |

| **9. RREZIKU NGA AKSIDENTET** | | |
|---|---|---|
| 9.1. | Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm | **Plani i mbrendshem do te permbajë:**<br>**Objektivat e Planit:**<br>➢ Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve,<br>➢ Ruajtja dhe mbrojtja e ambientit,<br>➢ Vlerësimi i rrezikut, parandalimi i zjarreve mbrojtja dhe ruajtja e pasurisë dhe të mirave materiale,<br>**Qëllimi i planit:**<br>Qëllimi i hartimit të këtij Plani është:<br>• Zvogëlimi i rrezikut,<br>• Gadishmeria për të marrë vendime të duhura dhe kordinimi i veprimeve (në raste të zjarreve përmasash të mëdha),<br>• Krijimi i prioriteteve për një kordinim sa më efikas në mes të subjekteve të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rastet e fatkeqësive/zjarreve.<br>**Plani i jashtëm**<br>Qëllimet kryesore të këtij Plani janë: Tërheqja e vemendjes së përdoruesve dhe të autoriteteve përkatëse ndaj mundësisë së paraqitjes së një aksidenti dhe zbatimit të masave për shmangien e tij, të shmang efektet serioze (si p.sh. vdekjet nga aksidentet), te zvogëlojë shfaqjen e efekteve, të zvogeloje rrezikun e ndodhjes së aksidenteve ose të zbusë pasojat e aksidenteve kur ato ndodhin.<br>Për realizimin e objektivave të mësipërme, ky plan përmban këto qështje kryesore: ekipet e emergjencave dhe përgjegjësit e tyre, |

| | | |
|---|---|---|
| | | trajnimi i punëtorëve, klasifikimi i territorit sipas kategorise së kërcënimit nga aksidentet, përgjegjesitë. |
| 9.2. | Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre | Duke marrë parasysh natyren e punës që realizohet në këtë kompleks/deponi të mbeturinave metalike, punëtoret janë të vetëdijëshem për substancat dhe komponimet kimike me të cilat ata punojnë. Por mëqë në këte kompleks nuk bëtët ndonjë trajtim apo riciklim i tyre, atehërë zvogëlohet mundësia e rrezikut nga ndonjë problem serioz, sepse vajrat dhe fluidet tjera që konsiderohen të rrezikshme vetëm largohen nga automjeti mbeturin dhe vendosen në seperatoret dhe rezervarët përkatës së llojit. Pra, nuk kemi ndonje përpunim apo riciklim të metutjeshëm. |
| 9.3. | Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave | **Masat që janë marrë në raste aksidenti**<br>- Janë marre masat për evidentimin e derdhjeve të derivateve të naftës, vajit motorik dhe fluideve tjera nga automjetet mbeturine, makinat transportuese dhe ato ngarkuese.<br>- Në rastet kur kemi rrjedhje të vajrave dhe fluideve si mbeturina specifike që mund të ndodhin gjatë procesit, atëherë lëngu i derdhur pastrohet me absorbues kimik të cilat me lopata mblidhen dhe futen në fuqi ku mbahen në depo derisa të merren nga kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre.<br>- Në mënyrë permanente mirëmbahet ambienti në kompleks të deponisë<br>- Pronari mbanë evidencën dhe ruan shënimet për dërgimin e tyre në qendrat e licencuara për riciklim, për sasinë dhe llojin e mbeturinave të seleksionuara, dhe sasinë dhe llojin mbetjeve nga mbeturinat, me qëllim që të vërtetohet dalja e mbeturinave në këtë lokacion (vendi për grumbullimin e mbeturinave).<br>- Evidenca dhe shënimet mbahen sipas rekomandimeve që jepen ne Ligjin për Mbeturin Nr. 02/L-30 dhe Udhëzimeve |

| | | |
|---|---|---|
| | | administrative për mbeturina të hartuara sipas rekomandimeve nga Ligjin për Mbeturina Nr. 04/L-060 dhe Ligji për mbeturina Nr.08/L-071. |
| 9.4. | Raporti mbi gjendjen e sigurisë | Raporti i sigurisë përmbanë këto të dhëna dhe informata:<br>**Shënimet e lokacionit** ku gjendet impianti/deponia e mbeturinave metalike, duke përfshirë pozitën gjeografike, kushtet meteorologjike, gjeologjike dhe hidro-grafike, të dhënat mbi terrenin; përcaktimi i stabilimenteve dhe aktiviteteve të tjera të impiantit të cilat mund të paraqesin rrezik nga aksidentet e mëdha; përshkrimi i zonave ku mund të vijë deri te efekti domino nga aksidenti i madh, përshkrimi i aktiviteteve kryesore, burimit të rrezikut nga aksidentet e mëdha dhe rrethanave nën të cilat një aksident i tillë mund të ndodhë si dhe përshkrimi i masave preventive të planifikuara; përshkrimi i procedurave, në rend të parë mënyra e punës;<br>-**Përshkri**mi i substancave të rrezikshme, i cili përfshin:<br>Sasinë më të madhe të substancave të rrezikshme që mund të jenë te pranishme në lokacion; vetitë fizike, kimike dhe toksikologjike të substancave të rrezikshme dhe paralajmërimet e rrezikut për njeriun dhe Mjedisin, vërtetimin e substancave të rrezikshme: emërtimi kimik, numri CAS (Chemichal Abstract Simbol), emërtimi sipas nomenklaturës IUPAC.<br>-Vërtetimi dhe analiza e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mënyra e pengimit.<br>-Vlerësimi i pasojave të konstatuara nga aksidenti i madhë.-Përshkrimi i pajisjeve të shfrytëzuara gjatë sigurimit të stabilimenteve.<br>-Përshkrimi detal i rrjedhjes së mundshme të aksidenteve të mëdha dhe mundësisë së ndodhjes së tyre ose kushtet nën të cilat mund të ndodhin, duke përfshirë përshkrimin e situatës që mund të |

| | | |
|---|---|---|
| | | shkaktojnë në njërin nga zhvillimet e cekura të saj, pa marrë parasysh se a janë shkaktarët brenda stabilimentit ose jashtë tij;<br>-Masat mbrojtëse dhe masat për intervenim për kufizimin e pasojave të aksidentit:<br>Përshkrimi i pajisjeve në stabilimente të shfrytëzuara për kufizimin e pasojave nga aksidentet e mëdha; organizimi i alarmimit dhe intervenimi, përshkrimi i mjeteve të jashtme dhe të brendshme që janë në dispozicion; |
| 9.5. | Plani për mbrojtjen nga zjarri | **MASAT PRAKTIKE DHE TEKNIKE PËR SHUARJEN E ZJARRIT**<br>Shkaqet e ndezjes së zjarrit duhet mënjanohen, ose të pakësohen.<br>- Kompania ka siguruar paisjet kunder zjarrit,<br>- Janë trajnuar shumica e punëtoreve për përdorimin e pasijeve kundër zjarrit<br>- Janë marrë masa për sigurinë e përgjithshme kunder pëlcitjes aksidentale apo te qëllimshme te zjarrit<br>**Planifikimi dhe përgatitja paraprake:**<br>• Për shuarjen e zjarrit të përdoren aparatet mobile zjarrfikëse që janë të vendosur në vendet ku është me efikas p.sh. në hapësirat ku bëhet prerja me flakë të hapur, aparat saldimi etj. Zakonisht vendosen dy aparate mobile zjarrfikëse të tipit (S9) dhe një arkë me rërë.<br>• Në korridoret dhe hapësirat tjera të impiantit instalohen hidrantët me pajimet përcjellëse dhe aparatet plotësuese.<br>• Janë merrë të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat mbeturine dhe ato transportuese.<br>• Është bërë plani i intervenimit për raste të aksidenteve mjedisore.<br>• Në rastet kur kemi rrjedhje të vajrave dhe fluideve si mbeturina specifike që mund të ndodhin gjatë procesit |

| | | |
|---|---|---|
| | | çmontues, atëherë lëngu i derdhur pastrohet me absorbues kimik apo me ashkla të imta druri të cilat me lopata mblidhen dhe futën në fuqi ku mbahen në depo deri sa të meren nga kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre.<br>• Në mënyrë permanente mirëmbahet ambienti i deponisë për trajtimin grumbullimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinat nga paisjet elektrike. |

| 10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT | | |
|---|---|---|
| 10.1 | Ndërprerja momentale e punës së impiantit | Nuk ka ndërprerje momentale të punës së impiantit përveq nese kemi nderprerje momentale të rrymës elektrike. |
| 10.2 | Ndërprerja e punës | Nuk ka ndalje të punës |

| 11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT |
|---|
| Gjatë funksionimit të vazhdueshëm të kompleksit të Kompanisë “TRIMI METAL” - Sh.p.k., e cila si aktivitet ka mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin fizik të mbeturinave sipas kodeve: 13 01 01*, 13 02 04*, 13 02 05*, 13 02 06*, 13 02 07*, 13 02 08*, 13 05 02*, 15 01 04, 15 01 06, 16 01 03, 16 01 04*, 16 01 06, 16 01 07*, 16 01 13*, 16 01 19, 16 02 11*, 16 06 01*, 16 06 02*, 16 06 05, 16 06 06*, 16 08 01, 17 02 02, 17 02 03, 17 04 01, 17 04 02, 17 04 03, 17 04 04, 17 04 05, 17 04 06, 17 04 07, 19 10 01, 19 10 02, 20 01 01, 20 01 23*, 20 01 33*, 20 01 34, 20 01 35*, 20 01 36, në zonen kadastrale Lubizhdë komuna e Prizrenit, me respektimin e plotë të udhëzimeve të dhëna në raportin e VNM dhe lejës mjedisore, gjithnjë të parapara më ligj dhe aktet nënligjore në fuqi, atëherë ndikimi i mundshëm i ndotjes në ndotjen e mjedisit dhe shëndetin e njëriut është minimal. |

| | |
|---|---|
| **Personi përgjegjës për mjedis** | **Personi përgjegjës i kompanisë** |
| **Emri mbiemri** | **Emri Mbiemri** |
| **Dr.sc. Edona Kabashi – Kastrati** | **Leutrim Shaqiri** |
| **Nënshkrimi** | **Nënshkrimi** |
| _________________ | _________________ |